



**SHPLLJE PËR NËPUNËS CIVILË LËVIZJE PARALELE DHE
NGRITJE NË DETYRË NË KATEGORINË E MESME DHE TË ULËT
DREJTUESE**

**DREJTOR, DREJTORIA E STATISTIKAVE TË BUJQËSISË DHE MJEDISIT,
KLASA II-1**

Në zbatim të nenit 26, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Instituti i Statistikave shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë për pozicionin:

– Drejtor, Drejtorja e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit, , Klasa II-1

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për LËVIZJE PARALELE: **26 Prill 2024**

Afati për dorëzimin e dokumentave për NGRITJE NË DETYRË: **2 Maj 2024**

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

Drejtori i Drejtorisë së Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit (DSBM) përcakton, harton, përpunon dhe prodhon të gjithë treguesit statistikorë të sektorit bujqësorë dhe mjedisor të miratuara në Programin e Statistikave Zyrtare (PSZ). Në procesin e punës për realizimin objektivave të vendosur në PSZ kjo drejtori komunikon, bashkëpunon dhe bashkëvepron me të gjithë drejtoritë e tjera në INSTAT dhe sektorët e tyre përbërës. DSBM harton rregulloren specifike mbi funksionimin e brendshëm të drejtorisë mbështetur në parimet e komunikimit dhe bashkëpunimit.



1. LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori II,
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi,
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” apo Master Profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, në Shkenca Ekonomike. Edhe diploma e nivelit Bachelor të jetë në të njëjtën fushë.
- b- Te kenë të paktën 5 vite përvojë pune në profesion dhe 3 vite në nivel të ulët drejtues.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Kërkesë për pozicionin
- b- Jetëshkrim i aplikantit (model europass);
- c- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- h- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- i- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- j- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në INSTAT brenda **datës 26 Prill 2024**.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **30 Prill 2024**, Instituti i Statistikave do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të Institutit të Statistikave dhe stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Instituti i Statistikave, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

1. Njohuritë mbi Ligjin Nr. 17/2018 Për Statistikat Zyrtare – <http://www.instat.gov.al>
2. Njohuritë mbi Ligjin e Nënpunësit Civil Nr. 152/2013 – <http://www.dap.gov.al>
3. Njohuri mbi Rregulloren Nr. 2018/1091 “Për Statistikat e Integruara të Fermës” – <http://eur-lex.europa.eu>
4. Njohuri mbi Rregulloren Nr. 1165/2008 të BE-së për Statistikat e Blegtorisë dhe Prodhimit të mishit – <http://eur-lex.europa.eu>
5. Njohuri mbi Rregulloren e Eurostat për prodhimin e statistikave të Prodhimit Bimor - Rregullore 543/209 për ‘Statistikat vjetore të prodhimit bimor’ – <http://eur-lex.europa.eu>
6. Njohuri mbi Rregulloren e Eurostat për prodhimin e statistikave të Mbetjeve - Rregullore 2150/2002 për ‘Statistikat e Mbetjeve’ - <http://eur-lex.europa.eu>
7. Njohuri mbi Rregulloren e Eurostat për Llogaritë Ekonomike në Bujqësi - Rregullorja 138/2004 për ‘Llogaritë Ekonomike në Bujqësi’ – <http://eur-lex.europa.eu>

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe për vlerësimet e rezultateve individuale në punë. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1, Njësia Administrative Nr.2, 1017

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **60 pikë**.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015 të DAP www.dap.gov.al.

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Instituti i Statistikave do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen e internetit të Institutit të Statistikave dhe stendat e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

2. NGRITJA NË DETYRË

Vetëm në rast se pozicioni i cituar më sipër, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Këtë informacion do ta merrni në faqen e internetit të INSTAT dhe në portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, si dhe stendat e informimit të publikut duke filluar nga data **13 Maj 2024**.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati (Nëpunës Civil) në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në kategorinë III;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vertetuar me një dokument nga institucioni);
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” ose “Shumë mirë”;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” apo Master Profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, në Shkenca Ekonomike. Edhe diploma e nivelit Bachelor të jetë në të njëjtën fushë.
- b- Te kenë të paktën 5 vite përvojë pune në profesion dhe 3 vite në nivel të ulët drejtues.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët (nëpunës civilë) duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Kërkesë për pozicioin
- b- Jetëshkrim i aplikantit (modeli europass);
- c- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- h- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- i- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- j- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në Institutin e Statistikave brënda datës **2 Maj 2024**.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **13 Maj 2024**, Instituti i Statistikave do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të INSTAT dhe stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim për njohuritë mbi dokumentet e listuara në pikën 1.4



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Instituti i Statistikave do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail). Instituti i Statistikave do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe standat e informimit të publikut.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë, do të marrin informacion në faqen e internetit të INSTAT, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- Datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi, duke filluar nga data **13 Maj 2024**.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1, Njësia Administrative Nr.2, 1017

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al